



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1148/1 Prot.

Tiranë, më 10 / 08 / 2020

V E N D I M

Nr. 82 , Datë 10 /08/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.33 regj, datë 13.05.2020, që i përket ankuesit P.I i cili pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*” nga Bashkia Mallakastër. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon: “Kam bindje të plotë se jam pushuar nga puna vetëm politikisht. Kam mbi 30 vite pune. Kam punuar agronom para ndryshimit të sistemit dhe më pas mësues në lëndët biologjiki, N/Drejtor dhe Drejtor shkolle për shumë vite. Kam punuar në Komunën Qendër Mallakastër në Kadastër, Përgjegjës Sektori në Bordin e Kullimit Mallakastër, Drejtor i Shërbimit Pyjor Mallakastër për afro 7 vjet dhe së fundmi Inspektor Pyjesh, në Bashkinë Mallakastër.

Në mars 2019, gjatë kohës që punoja si inspektor në bashki, arrestohem se mora pjesë në protestë në Fier me akuzën se kam qëlluar policinë. Jam liruar nga gjykata pasi u vërtetua se nuk isha unë personi që kishte qëlluar policinë. Më pas kam vazhduar punën normalisht si inspektor pyjesh. Gjatë gjithë kohës si inspektor pyjesh në bashki kam punuar me përkushtim, pa njohur orare pune dhe ditë festash. Gjatë kohës që kam punuar si inspektor pyjesh kam konstatuar se territori i Bashkisë Mallakastër ishte zvogëluar me 1/8 e sipërfaqes. Duke marrë pjesë në takime në Ministri, në seminare, në bashkitë fqinje këmbëngula dhe kufiri bashkiak u rikthye atje ku ishte.

Pushohem nga puna nga Kryetari i Bashkisë për suprimim të vendit të punës, pasi i kanë ndryshuar emrin drejtorisë nga Drejtoria e Mjedisit në Drejtori e Bujqësisë, Ushqimit dhe Menaxhimit të Pyjeve si dhe duke ndryshuar emrin e inspektorëve të pyjeve me specialist pyjesh. Më kanë hequr mua si agronom dhe bio-kimist dhe kanë marrë punonjës të rinj me shkollë të mesme për veteriner ose pa shkollë fare. Vendin tim e ka zënë një person me arsim të mesëm. Të gjitha këto më bëhen

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

pasi jam anëtar i Partisë Demokratike që nga themelimi i saj, duke mbajtur pozicione në parti si, kryetar dhe sekretar seksioni, sekretar grup seksioni, këshilltar dhe nënkryetar i Këshillit të Komunës Qendër si përfaqësues i Partisë Demokratike. Ndihej i diskriminuar nga Bashkia Mallakastër, pasi jam pushuar nga puna vetëm për bindjet politike dhe se nuk ka asnjë shkak tjetër për pushimin nga puna si, paaftësi në punë, arsimi apo moskryerje të detyrave të ngarkuara.”

Në përfundim ankuesi kërkon nga Komisioneri rikthimin në punë dhe dëmshpërblim moral.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”², që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi (neni 1³). Neni 3, i Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, *bazuar në bindjet politike*, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu *pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për*

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfutimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo **lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**.”

Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr.574/1 prot., datë 20.05.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Mallakastër. Me shkresën nr.1069/1 prot., datë 12.06.2020⁵, Bashkia Mallakastër ka kthyer përgjigje, por nuk dërgoi të plotë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Në parashtrimet e saj Bashkia Mallakastër ka sqaruar se:

Ankuesi P.I ka filluar marrëdhënien e punës në Bashkinë Mallakastër më datë 03.04.2017 në pozicionin e punës Inspektor Pyjesh. Marrëdhënia e punës me z. I ka zgjatur deri më datë 17.03.2020. Në dhjetor 2019 miratohet struktura organizative e cila do të jetë funksionale për vitin 2020. Bashkia Mallakastër iu nënshtrua procesit të riorganizimit strukturor duke pasur shkurtime të vendeve të punës. Me strukturën funksionale për vitin 2019, Drejtoria e Mjedisit kishte në përbërjen e vet rreth 37 punonjës të kategorizuar në: Drejtor, Përgjegjës Sektori, Inspektor Pyjesh dhe Vrojtues Pyjesh. Me miratimin e strukturës së vitit 2020, Drejtoria e Mjedisit pësoi riorganizim strukturor duke çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Drejtorisë në 16 punonjës.

Procesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimi i fuqisë punëtore është një proces dinamik që ka prekur punonjës të profesioneve dhe moshave të ndryshme. Janë prekur punonjës me vendbanim në zona të ndryshme të Mallakastrës ku përgjigjeshin për ruajtjen e pyjeve dhe mjedisit. Gjithashtu efektet e tij janë shpërndarë duke prekur punonjës me vjetërsi pune të ndryshme duke respektuar afatin e njoftimit për cilindo punonjës që u prek nga procesi i ristrukturimit organizativ.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me z. P.I nuk është e lidhur aspak me individin, por me një pushim të kryer në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Mallakastër, i cili ka përfshirë një numër të konsiderueshëm punonjësish. Lidhur me pretendimin për diskriminim të z. I për shkak të bindjes politike, Bashkia Mallakastër sqaron se nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por administron vetëm të dhëna personale të punonjësve, për të cilat është marrë miratimi i tyre me shkrim. Pretendimi i paraqitur nga z.I për bindjen e tij politike është një pretendim i panjohur për ne dhe nuk ka prova apo dokumente të paraqitura apo të administruara më parë në dosjen personale të këtij punonjësi. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale të ankuesit që disponohet nga punëdhënësi, nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë e tij politike.

Bashkia Mallakastër thekson faktin se në dijeninë e saj dhe nga informacioni zyrtar publik (kandidim publik për një forcë të caktuar politike, të njëjtë me atë të deklaruar nga z. I) janë në marrëdhënie pune, punonjës që kanë kandiduar zyrtarisht për forcën politike të njëjtë me atë të deklaruar nga z. I (referuar informacioneve të siguruara nga faqja zyrtare e KQZ për listat e kandidatëve për kryetar komune, konkretisht z.N.K dhe z. P.G të cilët kanë qenë të zgjedhur dhe kanë ushtruar detyrën si kryetar Komune), fakt që tregon se në asnjë rast, marrëdhëniet e punës ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe punonjësve të saj nuk lidhen me përkatësinë e tyre politike.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.747 prot., datë 16.04.2020.

Bashkia Mallakastër nuk ka bërë asnjë hetim për përbërjen politike të punonjësve, por marrëdhëniet e punës kanë përfunduar vetëm për punonjësit të cilëve i'u janë shkurtuar pozicionet e punës apo ka patur shkak tjetër ligjor.

Pretendimet e palës ankuese se është zëvendësuar nga një punonjës me arsim të mesëm, janë të pavërteta sepse pozicioni përkatës si inspektor pyjesh i z.I është suprimuar dhe në pozicionin e punës si specialist pyjesh është sistemuar punonjësi G.Ç me arsim të lartë në përshtatje me profilin e kërkuar në strukturën organizative të vitit 2020. Për nevoja të institucionit, për mbulim të një zone të caktuar, z. A.Z është punësuar me kontratë 3 (tre) mujore. Bashkia Mallakastër hedh poshtë çdo pretendim të ankuesit për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

- Me shkresën nr.1004 prot., datë 15.07.2020, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Mallakastër plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit.
- Me shkresën nr.1580/1 prot., datë 21.07.2020⁶, Bashkia Mallakastër dërgoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.
- Me shkresën nr. 574/2 prot, datë 20.05.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion shtesë nga ankuesi, i cili ktheu përgjigje me shkresën nr.574/3 prot., datë 01.06.2020, duke dërguar dokumentacionin e kërkuar.
- Më datë 18.07.2020⁷, ankuesi ka paraqitur kundërshtimet mbi qëndrimin dhe shpjegimet e Bashkisë Mallakastër, duke parashtruar se:

Bashkia Mallakastër pretendon se numri i punonjësve të Sektorit të Mjedisit nga 37 është reduktuar në 16, ju bëj me dije se nga këta punonjës 20 kanë qenë vrojtues pyjesh, të marrë në punë për emergjencë, në kuadër të luftimit, parandalimit dhe kultivimit të bimëve narkotike, ku një pjesë e mirë e tyre paguhen me orë pune. Në pozicionin “Inspektor pyjesh” ishim 3 punonjës, P.I, N.K dhe B.H (theksoj se me përvojën më të madhe në punë isha unë).

Bashkia Mallakastër pretendon se është suprimuar vendi i punës duke ndryshuar vetëm emrin nga inspektor pyjesh në specialist pyjesh. Sot janë 4 specialist pyjesh, N.K, S.C, G.Ç dhe A.Z. Po citoj vetëm një nga detyrat që kanë sot specialistët e pyjeve: *“Specialisti i pyjeve ka për detyrë konstatimin e ndërhyrjeve, dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të pyjeve, tokës pyjore, kullotave dhe livadheve brenda territorit të Bashkisë.”* Citova vetëm një nga detyrat e specialistëve të pyjeve, pasi të gjitha detyrat e specialistëve të pyjeve janë të njëjta me ato të inspektorëve të pyjeve.

Për sa i përket arsimimit të z. G.Ç në dijeninë time ka mbaruar Biologji-Kimi, nuk di a ka mbaruar masterin apo jo, ndërsa unë jam me diplomë të nivelit të dytë të integruar për agronomi të përgjithshme dhe biologji kimi, te diploma biologji kimi kam mbrojtur biologjinë. Për sa i përket z. A.Z, i cili është me arsim të mesëm për veterinarin dhe Bashkia pretendon se e ka marrë për emergjencë dhe me kontratë 3 mujore, megjithëse kanë kaluar mbi tre muaj është ende në atë pozicion.

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1080 prot., datë 23.07.2020.

⁷ Dërguar me email.

Bashkia Mallakastër pretendon se për mua nuk ka fare dijeni për bindjet e mia politike po vetëm për z. N.K dhe z. P.G. Unë kam qenë Këshilltar i Komunës Qendër nga zgjedhjet e vitit 1996 deri në vitin 2011 nga subjekti Partia Demokratike. Bashkia Mallakastër për pushimin tim nga puna është nisur vetëm dhe vetëm nga bindjet e mia politike..

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mallakastër me detyrë “Inspektor pyjesh”, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, në Drejtorinë e Mjedisit. Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe Bashkisë Mallakastër kanë zgjatur nga data 03.04.2017 kur ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune, bazuar në urdhrin nr.69 datë 03.04.2017, të Kryetarit të Bashkisë, deri më datën 17.03.2020, kur ankuesi është liruar nga ky pozicion pune, bazuar në urdhrin nr.51, datë 16.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë. Bazuar në kontratën e punës me nr. 2619 prot, datë 03.04.2019 ankuesi dhe Bashkia Mallakastër kanë lidhur një kontratë pune me afat të papërcaktuar.

Referuar urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nr.51, datë 16.01.2020 Bashkia Mallakastër ka vendosur të zgjidh kontratën e punës me ankuesin për shkak se pozicioni i punës i mbajtur prej ankuesit në zbatim të VKB nr.104, datë 20.12.2019 *“Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe institucioneve të varësi, strukturës organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Mallakastër për vitin 2020”*, është suprimuar. Bazuar në këtë urdhrë ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në datë 17.03.2020. Ankuesi e kundërshton arsyen e deklaruar nga ana e punëdhënësit duke pretenduar se vendi i tij i punës nuk është suprimuar nga VKB nr.104.02.12.2019 por zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike dhe jo për shkak të suprimimit të vendit të punës nga ristrukturimi, sikundër pretendohet nga Bashkia Mallakastër.

Nga aktet e administruara, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve, struktura dhe organika e Bashkisë Mallakastër, gjatë vitit 2019, është rregulluar në bazë të Vendimit Nr.91 datë 20.12.2018, të Këshilli Bashkiak Mallakastër(VKB). Bazuar në këtë VKB numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin 2019, ka qenë 434. Në pikën 1.3-3 *“Funksione të transferuara”* të këtij akti përcaktohet se 4 pozicione pune “Specialist pyjesh” janë funksione të transferuara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakastër. Referuar strukturës organizative të Bashkisë Mallakastër për vitin 2019, rezulton se, Drejtoria e Mjedisit ka patur në përbërje: Drejtorin e Drejtorisë dhe 4 sektorë, konkretisht: Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit (26 punonjës), Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore (5 punonjës), Sektori Mbrotjtja e Konsumatorit dhe Shërbimi Veterinar (5 punonjës), Sektori i Shfrytëzimit të Pyjeve e të Prodhimeve të tjera Pyjore e Jopyjore (7 punonjës), me një total prej 44 punonjësish. Sektori i Pyjeve dhe i Mjedisit ka patur gjithsej 26 punonjës, nga të cilët: 1 Përgjegjës sektori, 3 Inspektorë pyjesh, 1 Specialist i zonave të mbrojtura, 1 Specialist dhe 20 Vrojtues pyjesh.

Me Vendimin Nr.104/20.12.2019, Këshilli Bashkiak Mallakastër ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësinë e saj për vitin 2020. Bazuar në këtë VKB numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin 2020 është përcaktuar të jetë 439, pra 5 punonjës më shumë se numri i punonjësve për vitin 2019. Në pikën 1.2 “*Funksione të transferuara*”, nën pika 1.2-3, të këtij akti rezulton se 4, pozicione pune “Specialist pyjesh” janë funksione të transferuara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakastër, i njëjti parashikim si në strukturën e vitit 2019. Referuar strukturës organizative të Bashkisë Mallakastër për vitin 2020, rezulton se, Drejtoria e Mjedisit është ristrukturuar duke u emërtuar Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe AKU-së dhe nga 4 sektorë dhe 44 punonjës, me strukturën e viti 2020, ka në përbërje Drejtorin e Drejtorisë, 2 sektorë konkretisht Sektorin e AKU-së dhe Bujqësisë (8 punonjës) dhe Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit (7 punonjës), 16 punonjës gjithsej. Më konkretisht nga 7 punonjës të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, 1 është Përgjegjës sektori, 4 janë Specialist pyjesh dhe 2 Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura.

Nga të dhënat rezulton se në numër total punonjësish Bashkia Mallakastër nuk ka pësuar shkurtime, pasi me strukturën e 2019 ka patur 434 punonjës ndërsa me strukturën e 2020 ka 439 punonjës, pra 5 punonjës më shumë. Rezulton se nga ristrukturimi Drejtoria e Mjedisit, ka pësuar ndryshime dhe shkurtime në numër punonjësish, por të dhënat tregojnë se sipas strukturës së 2020, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit nuk është suprimuar si sektor dhe se shkurtime në këtë sektor kanë prekur pozicionin e punës si “Vrojtues Pyjesh”. Në strukturën e vitit 2019 Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit ka patur në përbërjen e tij 20 “Vrojtues Pyjesh”, ndërkohë që me strukturën e vitit 2020 nuk ka asnjë pozicion të tillë. Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit nga 26 punonjës me strukturën e 2019 rezulton se ka 7 punonjës me strukturën e 2020. Shkurtime të vendeve të punës janë të konsiderueshme, por duket qartë se shkurtime kanë prekur pozicionet e punës si “Vrojtues pyjesh” dhe është shtuar 1 pozicion pune specialist pyjesh

Me një vendim të mëvonshëm nr.166/1 datë 05.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë janë bërë disa ndryshime të strukturës organizative të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve të saj të varësisë, të cilat prekin edhe Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit. Sipas pikës 1, të këtij akti rezulton se 2 pozicionet e punës të emërtuara “Specialist mjedisi dhe zonave të mbrojtura” do të ndryshojnë në këtë mënyrë: 1 pozicion pune emërtohet Specialist mjedisi dhe 1 pozicion pune emërtohet Specialist Pyjesh. Me këtë ndryshim numri total i pozicioneve të punës Specialist pyjesh në këtë sektor shkon nga 4 në 5. Pra, konfigurimi përfundimtar i këtij sektori është: 1 Përgjegjës sektori, 5 Specialist pyjesh dhe 1 Specialist mjedisi.

Nga analiza e dy strukturave të Bashkisë Mallakastër për vitin 2019 dhe 2020, Komisioneri konstaton se, pozicioni i punës i emërtuar Inspektor Pyjesh sipas strukturës së 2019 ka qenë i pozicionuar në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, ndërkohë që edhe pozicioni i punës Specialist Pyjesh sipas strukturës së vitit 2020 po ashtu është i pozicionuar në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit. Bazuar në VKB nr.91/20.12.2018, në pikën 1.2-3 ku specifikohen funksionet e transferuar citohet se 4 pozicione “Specialist pyjesh” janë funksione të transferuara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakastër, ndërkohë që sipas strukturës së miratuar për vitin 2019, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit nuk ka patur pozicione pune “Specialist pyjesh” por “Inspektor pyjesh”. Ky është një fakt që tregon se pavarësisht terminologjisë së përdorur “Inspektor pyjesh” apo “Specialist pyjesh” bëhet

fjalë për të njëjtin pozicion pune dhe se funksionet e ushtruara prej tyre janë të njëjta. Edhe në VKB nr. 104.20.12.2019 në pikën 1.2-3, parashikohen se janë funksione të transferuara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakastër, 4 pozicione Specialist Pyjesh.

Me shkresën nr.1069/1 prot, datë 12.6.2020, Bashkia Mallakastër sqaroi se pozicioni i punës “Inspektor pyjesh” nuk ka përshkrim pune, pasi nuk është pozicion pune që rregullohet me Ligjin “Për nëpunësin Civil” dhe detyrat e Inspektorit të pyjeve parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë. Referuar dokumentit të vënë në dispozicion nga Bashkia Mallakastër rezulton se në nenin 49 të Rregullores së Brendshme⁸, parashikohen detyrat e Inspektorit të pyjeve. Me shkresën nr.1580/1 prot., datë 21.07.2020, Bashkia Mallakastër vuri në dispozicion kopje të Rregullores së Brendshme⁹, duke theksuar se përshkrimi i punës për pozicionin e punës “Specialist pyjesh” parashikohet në Rregulloren e Brendshme. Në nenin 50, pika 4, të Rregullores së Brendshme, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të pyjeve. Referuar parashikimeve që bëhen në këto dispozita ku jepen respektivisht detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të pyjeve dhe Specialistit të pyjeve rezulton se, në thelb kemi të bëjmë me ushtrimin e të njëjtave deyra dhe funksione.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, punonjësi N.K, i cili ka mbajtur të njëjtin pozicion pune si ankuesi dhe vazhdon marrëdhëniet e punës me Bashkinë Mallakastër në pozicionin e “Specialistit të pyjeve”, është emëruar në bazë të urdhrin nr.82 datë 10.04.2017 të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Inspektor pyjesh”, në Drejtorinë e Mjedisit. Bazuar në listpagesat e punonjësve të Bashkisë Mallakastër për periudhën janar-qershor 2020, rezulton se, punonjësi N.K, i cili emërtimin e pozicionit në punë në bazë të urdhrin e ka “Inspektor pyjesh” është paguar si Specialist pyjesh, edhe pse nuk ka një urdhër emërimi në pozicionin si “Specialist pyjesh”. Sa më sipër rezulton se për punonjës N.K, i cili ka mbajtur të njëjtin emërtim si ankuesi, “Inspektor pyjesh” në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit”, Bashkia Mallakastër nuk ka nxjerrë asnjë akt për sistemimin e tij në pozicionin e ri të pretenduar se është krijuar atë të “Specialistit të pyjeve”. Bashkia e ka paguar këtë punonjës si Specialist pyjesh, duke e konsideruar të njëjtë pozicionin e punës të mbajtur prej tij si “Inspektor pyjesh” me pozicionin e “Specialist pyjesh”. Bashkia Mallakastër me pretendimin se pozicioni i punës “Inspektor pyjesh” është suprimuar, do të duhej të kishte nxjerrë një akt të ri për sistemimin e këtij punonjësi në pozicionin e ri të krijuar atë si Specialist pyjesh.

Duke ju referuar analizës së mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se pozicioni i punës “Inspektor Pyjesh” nuk është suprimuar dhe se në strukturën e vitit 2020 këtij pozicioni i korrespondon pozicioni i punës “Specialist Pyjesh”. Komisioneri vlerëson se, si pasojë e ristrukturimit pozicioni i punës “Inspektor pyjesh” ka ndryshuar vetëm emërtimin në “Specialist Pyjesh”, pasi rezulton se pozicioni i punës “Specialist pyjesh” me strukturën e 2020 dhe “Inspektor pyjesh” sipas strukture së 2019, kryejnë të njëjtat funksione dhe detyra. Pavarësisht shkrutimeve që ka pësuar Drejtoria e Mjedisit dhe Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, ku ka qenë pozicionuar pozicioni i punës “Inspektor Pyjesh”, këto shkurtime nuk kanë prekur këtë pozicion pune, por përkundrazi me

⁸ Rregullorja nuk është vendosur e plotë në dispozicion, por vetëm pjesa me nenet që rregullojnë funksionimin e Drejtorisë së Mjedisit.

⁹ Nuk ka referenca se kur është miratuar ky akt.

strukturën e viti 2020 numri i pozicioneve të punës “Specialist Pyjesh” (që i korrespondojnë pozicionit Inspektor pyjesh) është rritur.

Bazuar në shkresën nr.17 regj datë 06.01.2020, rezulton se Bashkia Mallakastër ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, në respektim të nenit 144/1 të Kodit të Punës. Rezulton se në datën 13.1.2020, është realizuar takimi midis ankuesit në cilësinë e punëmarrësit dhe Bashkisë Mallakastër në cilësinë e punëdhënësit, fakt ky që rezulton nga procesverbali datë 13.01.2020 i mbajtur gjatë këtij takimi. Në këtë takim ankuesit i është komunikuar se arsyeja e zgjidhjes së kontratës së punës është fakti se pozicioni i tij i punës pranë kësaj bashkie është suprimuar bazuar në VKB nr. 104/20.12.219. Referuar procesverbalit, ankuesi ka deklaruar se largimi i tij nga puna është i padrejtë dhe tendencioz dhe se ai nuk është njohur me strukturën e re dhe se nuk është mbajtur në konsideratë arsimimi i tij. Më pas, bazuar në urdhrin nr. 51 datë 16.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe financiare të ankuesit në datën 17.03.2020.

Fakti që kontrata e punës e ankuesit mund të jetë zgjidhur në respektim të procedurës dhe afateve të njoftimit të parashikuar nga Kodi i Punës, nuk e eliminon faktin se largimi i ankuesit nga puna ka ndodhur pa një shkak të ligjshëm, në kushtet kur rezultoi se vendi i punës i ankuesit nuk është suprimuar sikundër pretendon Bashkia Mallakastër.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna, nuk rezultoi e provuar. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm.

B. Shkaku i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁰, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për

¹⁰ Shih më lart *footnote* nr. 3.

mbrojtjen nga diskriminimi”, bindjet politike dhe gjendja arsimore, konsiderohen si shkaqe të mbrojtura nga ligji.

Ankuesi shpjegon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike pasi është anëtar i Partisë Demokratike dhe se bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të punëdhënësit të tij, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër. Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesi ka depozituar dokumentacion që provon jo vetëm anëtarësimin e ankuesit në Partinë Demokratike Dega Mallakastër, por edhe aktivizimin e tij në struktura të ndryshme të kësaj partie si dhe aktivitetin e tij politik si përfaqësues i kësaj partie.

Referuar vërtetimit me nr.6 prot., datë 28.05.2020, lëshuar nga Partia Demokratike Dega Mallakastër, rezulton se ankuesi është anëtar i kësaj partie nga themelimi i saj datë 08.03.1991 dhe se, ankuesi ka mbajtur dhe mban pozicione të ndryshme brenda strukturave të kësaj partie si, Sekretar Seksioni në fshatin Drenovë, Komuna Qendër Mallakastër (viti 1991), Sekretar i Grupseksionit të Komunës Qendër Mallakastër (1997-2015), Kryetar Seksioni dhe Sekretar Seksioni Drenovë e Re, Komuna Qendër Mallakastër (që prej vitit 1997) dhe aktualisht ankuesi është Sekretar Seksioni fshati Drenovë e Re, ish Komuna Qendër Mallakastër.

Bazuar në vërtetimin e mësipërm, të lëshuar nga Partia Demokratike Dega Mallakastër, rezulton se në zgjedhjet lokale të vitit 1996, 2000, 2003, 2007, ankuesi është zgjedhur Këshilltar i Komunës Qendër Mallakastër, si përfaqësues i Partisë Demokratike dhe në vitet 2000-2003 ka qenë N.Kryetar i Këshillit të Komunës Qendër. Bazuar në dokumentin “*Vërtetimin për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Komunës*”, lëshuar me datë 13.10.2003 nga Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore të Këshillit të Komunës Qendër Mallakastër, vërtetohet se ankuesi është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës Qendër, si përfaqësues i Partisë Demokratike. Fakti që ankuesi ka qenë Këshilltar në Këshillin e Komunës Qendër Mallakastër, rezulton edhe nga pagesat e kryera nga kjo komunë në emër të këshilltarëve, ku figuron edhe emri i ankuesit¹¹.

Rezulton se Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z.Q.I, është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Mallakastër në Qershor 2019 i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste¹².

Në kohën që ka ndodhur largimi nga puna i ankuesit, Partia Demokratike ka qenë forcë politike në opozitë.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “*bindjeve politike*” të kundërta me Kryetarin e Bashkisë Mallakastër, ky i fundit në cilësinë e punëdhënësit të ankuesit.

¹¹ Liste pagesa për Këshilltarët dhe Kryepleqtë, periudha janar –mars, 2004, faqe 2, numri 20; Lista e pagesës së rrogave për personalitete Këshilltarë, për kohën muaji maj 2001, numri rendor 22; Lista e pagesës së rrogave për personalitete Këshilltarë dhe Kryepleq, për kohën dhjetor, janar, shkurt, numri rendor 9.

¹² Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al, Formularit të Vetëdeklarimit dhe CV-së së z.Q.I.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar njëkohësisht edhe për shkak të gjendjes arsimore. Ankuesi shpjegon se diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore konsiston në faktin se nuk është mbajtur parasysh arsimimi i tij si agronom dhe biokimist dhe janë punësuar persona të rinj që nuk kanë arsimin përkatës. Përpos këtij shpjegimi, ankuesi thekson në ankesë se ai është pushuar nga puna vetëm për bindjet politike. Motivacioni i deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna të ankuesit nuk është mosplotësimi i kriterëve arsimore të vendit të punës pas ristrukturimit, por për shkak të suprimimit të vendit të punës. Pra, në thelb të pretendimeve të ankuesit për diskriminim qëndrojnë bindjet politike. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore duke u larguar nga puna dhe zëvendësuar me persona të cilët sipas tij nuk plotësojnë kriteret arsimore të vendit të punës, nuk ka shërbyer si bazë por pasojë e diskriminimit të pretenduar për shkak të bindjeve të politike. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimi i diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore është i pabazuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtje nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*¹³, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹⁴. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

¹³ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁴ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁵ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të opinionit politik.

Karta Sociale Europiane¹⁶ parashikon të drejtën për punë (neni 1) si dhe të drejtën për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimit (neni 24). Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër”.

Marrëdhëniet e punësimit për ankuesin rregullohen nga Kodi i Punës. Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Bazuar në nenin 9/2 të Kodit të Punës, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufzim apo parapëlqim që bazohet në një nga shkaqet e mbrojtura ndër të tjera edhe në bindjet politike, që ka si qëllim apo pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Ndërsa pika 5, germa c) e Kodit parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. Në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹⁷

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të

¹⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁶ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹⁷ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

këtij ligji. Bazuar në nenin 12/1/, Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalohet diskriminimi në lidhje me të drejtën për punësim, ndërsa në nenin 12/1c, ligji ndalon diskriminimin gjatë procesit disiplinor, pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁸ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie*

¹⁸ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek Bashkia Mallakastër, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse Bashkia Gjirokastrë, e cila pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁹

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ *të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*²⁰”.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar i Partisë Demokratike. Ankuesi ka parashtruar se, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të punëdhënësit, ka sjellë si pasojë largimin e tij nga puna. Bashkia Mallakastër prapësoi gjatë shqyrtimit të ankesës se nuk kishte dijeni për bindjet politike të ankuesit dhe se ajo administron vetëm të dhëna personale bazë të punonjësve, e për rrjedhojë ai nuk mund të pretendonte se po diskriminohej për shkak të bindjeve politike. Bashkia ka theksuar gjithashtu se, në dosjen personale të ankuesit që disponohet prej saj në cilësinë e punëdhënësit, nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë politike të ankuesit. Bashkia Mallakastër theksoi faktin se ajo nuk ka bërë asnjë hetim për përbërjen politike të punonjësve.

¹⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

²⁰ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Por, nga ana tjetër Bashkia Mallakastër deklaron se punonjësit N.K dhe P.G, të cilët kanë qenë të zgjedhur dhe kanë ushtruar detyrën si Kryetar Komune²¹, për të njëjtën forcë politike me ankuesin vazhdojnë marrëdhënien e punës, fakt ky që tregon se marrëdhëniet e punës ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe punonjësve të saj nuk lidhen me përkatësinë e tyre politike. Dijeninë mbi bindjet politike të punonjësve N.K dhe P.G, Bashkia Mallakastër deklaron se e ka nëpërmjet informacionit zyrtar dhe publik të siguruar nga faqja zyrtare e KQZ.

Rezulton se ankuesi në datën 09.3.2019, ka marrë pjesë në një protestë të organizuar nga Partia Demokratike në qytetin e Fierit. Në datën 1.3.2019 ankuesi është ndaluar nga Komisariati i Policisë Fier si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Goditjes për shkak të detyrës”, “Kundërshtim me dhunë të punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”, parashikuar nga nenet 236/2, 237 dhe 262/2 të Kodit Penal. Më pas ndaj tij me vendimin nr.378 datë 13.3.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vendosur masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, masë e cila është ndryshuar me vendimin nr. 60-2019-984 të Gjykatës së Apelit Vlorë në “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Bazuar në dosjen personale të ankuesit të vënë në dispozicion nga Bashkia Mallakastër, rezulton se me urdhrin nr.71, datë 25.03.2019, të Kryetarit të Bashkisë ankuesi është pezulluar nga detyra deri në përfundimin e procedimit penal të nisur në ngarkim të tij. Në bazë të urdhrin nr.93, datë 12.04.2019 të Kryetarit të Bashkisë, ankuesit i është hequr masa e pezullimit nga detyra. Bashkëlidhur urdhrin për heqjen e pezullimit janë administruar akte gjyqësore të lëshuara nga Gjykata e Apelit Vlorë, si procesverbal i seancës gjyqësore datë 09.04.2019 dhe kopje e dispozitivit të vendimit nr. 60-2019-984 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Komisioneri vlerëson se, prova për dijeninë e bindjeve politike mund të marrë formën e provave direkte ose rrethanore. Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se aktet e administruara nga Bashkia Mallakastër në dosjen personale të ankuesit, siç janë urdhri i pezullimit dhe i heqjes së tij, si dhe aktet e lëshuara nga Gjykata e Apelit Vlorë, janë prova direkte që tregojnë se Bashkia Mallakastër ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Provat rrethanore, gjithashtu mund të hedhin poshtë pretendimin e punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit. Disa fakte dhe prova rrethanore që mbështesin dijeninë për bindjet politike të ankuesit nga ana e punëdhënësit është fakti se:

Së pari, ankuesi përveç se është anëtar i Partisë Demokratike, ai në vazhdimësi që prej anëtarësimit të tij në Partinë Demokratike ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë funksione në strukturat e Partisë Demokratike Dega Mallakastër.

Së dyti, ankuesi i ka ekspozuar bindjet e tij politike duke qenë disa herë i zgjedhur në institucionet e pushtetit vendor në Bashkinë Mallakastër, si përfaqësues i Partisë Demokratike. Bashkia Mallakastër nuk mund të pretendojë dijeninë nga informacioni zyrtar publik për bindjet politike të punonjësve N.K dhe P.G dhe të kundërshtojë faktin e pasjes dijeni për ankuesin i cili në të njëjtën mënyrë me këta dy punonjës ka ekspozuar bindjet e tij politike duke kandiduar dhe zgjedhur si përfaqësues i Partisë Demokratike në organet e pushtetit vendor.

²¹ Referuar vendimit “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 08.05.2011”, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Së treti, përfshirja e ankuesit dhe arrestimi i tij gjatë protestës së datës 09.03.2019 të organizuar nga Partia Demokratike, është një ngjarje që nuk ka kaluar pa u bërë publike, në kanalet e ndryshme të komunikimit dhe medias. Kjo ngjarje e vendos ankuesin në një pozitë të ndryshme nga dy punonjësit e tjerë P.G dhe N.K, pasi tregon se ankuesi është aktiv në mbështetjen të forcës politike në të cilën aderohet, ndërkohë që për këta punonjës rezulton si aktivitet politik zgjedhja e tyre si përfaqësues të Partisë Demokratike në zgjedhjet vendore të viti 2011 dhe nuk tregon aspak për bindjet e tyre aktuale duke marrë në konsideratë faktin se çdokush është i lirë të ndryshojë bindjet e tij në çdo kohë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provat e mësipërme direkte dhe rrethanore, janë të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike duhet të ketë patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Gjithashtu vlen për t'u theksuar se pretendimi i Bashkisë Mallakastër se ka dijeni për kandidimin në zgjedhjet vendore të vitit 2011, si përfaqësues të Partisë Demokratike të punonjësve P.G dhe N.K, nëpërmjet informacioneve publike në faqen zyrtare të KQZ është kontradiktor me pohimin e bashkisë se nuk ka kryer asnjë hetim mbi bindjet politike të punonjësve.

Bazuar në shkresën nr.1580/1 prot., datë 21.07.2020, të Bashkisë Mallakastër rezulton se aktualisht në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit janë të punësuar 6 punonjës dhe konkretisht punonjësit H.Sh, V.Ll, S.C, G.Ç, A.Z dhe N.K. Bazuar në urdhrat e emërimit të këtyre punonjësve të vënë në dispozicion nga Bashkia Mallakastër rezulton se:

- 1- Punonjësi H.Sh, ka filluar punë bazuar në urdhrin nr.1351/6, datë 21.02.2014, të Ministrit të Mjedisit, në pozicionin Specialist në Seksionin Mallakastër, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Fier. Punonjësi H.Sh, i cili emërtimin e pozicionit të punës në bazë të urdhërit e ka “Specialist” në sektorin Mallakastër, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Fier, bazuar në listpagesat e punonjësve të Bashkisë Mallakastër, për periudhën janar-qershor 2020, është paguar si “Spec.pyjore” edhe pse nuk ka një urdhër emërimi në pozicionin si “Specialist pyjesh”.
- 2- Punonjësja V.Ll, ka filluar punë bazuar në urdhrin nr.140, datë 18.02.2020 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër në pozicionin Specialiste protokolli, për një afat të caktuar 3 mujor dhe më pas bazuar në urdhrin nr.363, datë 11.05.2020 të Kryetarit të Bashkisë është vendosur që kjo punonjëse të vazhdojë marrëdhëniet e punës në pozicionin “Specialiste mjedisi”, për një afat të pacaktuar. Bazuar në listpagesat e punonjësve të Bashkisë Mallakastër për periudhën janar-qershor 2020, rezulton se kjo punonjëse është paguar si Specialiste protokolli, në muajin shkurt 2020 dhe për periudhën mars-qershor 2020, është paguar si Specialiste pyjesh. Rezulton nga aktet e vëna në dispozicion, urdhrat e emërimit dhe listagesat e punonjësve, se kjo punonjëse është paguar si Specialiste pyjesh prej muajit mars deri në muajin qershor 2020 edhe pse për periudhën shkurt – 11 maj 2020 kjo punonjëse ka qenë e emëruar në pozicionin e Specialistes së protokollit. Jo vetëm kaq, por rezulton se në bazë të urdhrit të emërimit nr.363 datë 11.05.2020, kjo punonjëse është emëruar si Specialiste mjedisi dhe jo Specialiste pyjesh.
- 3- Punonjësi S.C, ka filluar punë bazuar në urdhrin nr.64, datë 31.01.2018 të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin Specialist, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit. Ky punonjësi, S.C, i cili emërtimin e vendit të punës në bazë të urdhërit të emërimit e ka “Specialist” në Sektorin e Pyjeve dhe

Mjedisit, është paguar në përputhje me emërtimin që ka në bazë të urdhërit, por jo në përputhje me pozicionet e punës të parashikuara sipas strukturës së re. Bazuar në strukturën e re 2020, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, nuk ka pozicion pune “Specialist” por emërtimet janë “Specialist pyjesh” dhe “Specialist mjedisi”.

- 4- Punonjësi G.Ç, ka filluar punë bazuar në urdhrin nr.244, datë 30.04.2020 të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin Specialist pyjesh, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, për një afat kohor të caktuar 3 mujor. Ky punonjës, i cili emërtimin e vendit të punës në bazë të urdhërit të emërimit e ka Specialist pyjesh në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, është paguar në përputhje me emërtimin që ka në bazë të urdhërit për periudhën maj – qershor 2020.
- 5- Punonjësi A.Z, ka filluar punë bazuar në urdhrin nr.185, datë 18.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin Specialist Pyjesh, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, për një afat kohor të caktuar 3 mujor dhe bazuar në urdhrin nr. 319 datë 22.06.2020 të Kryetarit të Bashkisë marrëdhënja e tij e punës në këtë pozicion është zgjatur edhe për 3 muaj të tjerë. Punonjësi A.Z, i cili emërtimin në bazë të urdhërit e ka Specialist pyjesh, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, është paguar në përputhje me emërtimin që ka në bazë të urdhërit për periudhën mars – qershor 2020.
- 6- Punonjësi N.K, është emëruar në bazë të urdhrit nr. 82, datë 10.04.2017 të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Inspektor pyjesh”, në Drejtorinë e Mjedisit. Siç është konstatuar edhe më sipër, ky punonjës është paguar si Specialist pyjesh edhe pse nuk ka një urdhër emërimi në pozicionin si “Specialist pyjesh” por Inspektor pyjesh.

Sa më sipër rezulton se punonjësit N.K, S.C dhe H.Sh janë punonjës të cilët kanë qenë të punësuar pranë Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, para miratimit të strukturës 2020 ndërsa punonjësit V.LI, G.Ç dhe A.Z janë punonjës të rinj të punësuar pas miratimit të strukturës për vitin 2020.

Bazuar në dosjen personale të punonjësi A.Z, rezulton se ai është marrë në punë me 2 kontrata pune të njëpasnjëshme me afat 3 mujor. Ky punonjës rezulton të ketë arsimim të mesëm për veterinari, në kundërshtim me nivelin arsimor dhe profilin e kërkuar për pozicionin e punës “Specialist pyjesh”. Bazuar në CV e tij të depozituar në dosjen personale ai nuk ka asnjë eksperiencë në fushën e pyjeve.

Bazuar në dosjen personale të punonjësit G.Ç, i cili është marrë në punë në bazë të një kontrate me afat 3 mujor, ky punonjës rezulton të jetë i pajisur me diplomë Mastër i Shkencave në Biologji Mjedisore, lëshuar më datë 10.10.2019. Bazuar në CV e tij depozituar në dosjen personale ai deklaron se ka disa eksperiencë pune gjatë kohës që ka kryer studimet e larta, por të pashoqëruara me dokumentacion provues.

Bazuar në dosjen personale të ankuesit rezulton se ai ka mbi 30 vite pune dhe eksperiencë pune si agronom, mësues në lëndët biologji-kimi, N/Drejtor dhe Drejtor shkolle, punonjës i kadastrës, përgjegjës sektori në Bordin e Kullimit Mallakastër, Drejtor i Shërbimit Pyjor Mallakastër për afro 7 vjet dhe së fundmi Inspektor Pyjesh, në Bashkinë Mallakastër që prej vitit 2017.

Sikundër është analizuar më sipër poizicioni Inspektor pyjesh dhe Specialist pyjesh kryejnë të njëjtat detyra dhe funksione. Pozicionet Specialist pyjesh në raport me pozicionet Inspektor pyjesh, nuk

kanë pësuar shkurtime, përkundrazi numri i tyre është rritur. Edhe nëse do të pranohet faktin se si pasojë e ristrukturimit pozicioni i punës Inspektor pyjesh është suprimuar, Bashkia Mallakastër duhet të kishte sistemuar punonjësit ekzistues përpara se të punësonte punonjës të rinj. Ankuesi ka një eksperiencë të gjatë punë e në mënyrë të posaçme në fushën e pyjeve. Për rrjedhojë, refuzimi i Bashkisë Mallakastër për të sistemuar ankuesin në pozicionin Specialist pyjesh, nëse do të pranohet se vendi i Inspektorit të pyjeve është suprimuar, nuk ka një shpjegim logjik kur të dhënat tregojnë se ai ka kualifikimin dhe një eksperiencë të gjatë në fushën e pyjeve përkundërt punonjësve të rinj që janë marrë në punë, cilët ose nuk kanë arsimin e kërkuar ose nuk kanë eksperiencën në profilin e kërkuar sikundër ankuesi.

Në kuadër të ristrukturimeve, punëdhënësi ka detyrimin që fillimisht të sistemojë punonjësit ekzistues në përputhje me arsimimin dhe kualifikimin e kërkuar nga vendi i punës. Bashkia Mallakastër ka sistemuar në pozicionin Specialist pyjesh, 3 prej punonjësve ekzistues në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit dhe konkretisht N.K, S.C dhe H.Sh, por nuk e ka bërë një gjë të tillë me ankuesin edhe në kushtet kur numri total i vendeve të punës Specialist pyjesh e lejonte një gjë të tillë. Bashkia duhet të kishte sistemuar ankuesin në pozicionet e lira Specialist pyjesh dhe më pas nëse do të rezultonin akoma vende të lira mund t'i plotësonte ato me punonjës të rinj, të cilët plotësojnë kriteret e vendit të punës.

Të pabazuara dhe kontradiktore janë veprimet e Bashkisë Mallakastër edhe në lidhje me punonjësen V.Ll, e cila është paguar për pozicion pune në të cilin nuk ka qenë e emëruar.

Por jo detyruesisht trajtimi i padrejtë ndaj të cilit është ekspozuar ankuesi mund të vijë si pasojë e bindjeve të tij politike. Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Mallakastër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm të tij. Sa më sipër, krijojnë bindjen se zgjidhja e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe që lidhen me suprimimin e vendit të punës.

Duke iu referuar faktit se ankuesi ka një aktivitet të konsiderueshëm si anëtar i subjektit politik Partia Demokratike dhe faktit që Bashkia Mallakastër nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e Bashkisë Mallakastër kanë qenë të motivuara politikisht.

Bazuar në nenin 9/10 të Kodit të Punës dhe nenit 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative në rastet kur pala paraqet prova mbi bazën e të cilave mund të prezumohet se ka patur diskriminim atëherë i takon palës tjetër që të provojë të kundërtën, se veprimet ose mosveprimet nuk përbëjnë diskriminim.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i tij në këtë mënyrë, pra largimi i tij nga puna është kryer për motive politike. Në këto kushte Bashkia Mallakastër kishte barrën e provës që të provonte ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i

lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Mallakastër, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore, pasi në mungesë të një justifikimi për ligjshmërinë e veprimeve nga ana e Bashkisë Mallakastër në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës, shkak i mbrojtur, pra bindjet politike të ankuesit mbeten i vetmi shpjegim i arsyeshëm për largimin nga puna.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi Bashkia Mallakastër ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit nuk është bërë për shkak të bindjeve të tij politike ose se largimi i tij ishte bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Mallakastër ka diskriminuar ankuesin P.I në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e kontratës së punës nuk ka ndodhur për shkak të suprimimit të vendit të punës, por për shkak të bindjeve politike të ankuesit. Për rrjedhojë Bashkia Mallakastër ka shkelur dispozitat e Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, gërma "c".

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*"

Bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcaktohet se : "*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*"

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Komisioneri vlerëson si të pabazuar me dispozitat e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" kërkimin e ankuesit për dëmshpërblim moral, pasi një kërkim i tillë është në kompetencë të gjykatës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit P.I, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Mallakastër.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Mallakastër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke emëruar ankuesin P.I në pozicionin Specialist pyjesh, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, në Drejtorinë e Bujqësisë, Mjedisit dhe AKU-së ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Bashkia Mallakastër detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim i drejtpërdrejtë